

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË
DEPARTAMENTI I MBROJTJËS SË BIMËVE



PUNIM DIPLOME - MASTER

**Ndjeshmëria e varieteteve të domates ndaj patogjenit *Phytophthora Infestans*
në mjediset e mbrojtura**

Mentori:

Prof. Asoc. Dr. Fadil Musa

Kandidatja:

BSc. Diellza Muhaxheri

Prishtinë, Shkurt 2023

ABSTRAKTI

Domatja (*Solanum lycopersicum*) është një nga kulturat perimore më të njohura në të gjithë botën. Kultivimi i domates çdo ditë e më shumë është në rritje si kulturë e freskët për konsum dhe përbërës kryesor në shumë ushqime. Domatja e kultivuar në kushte të mjediseve të mbrojtura është e ndjeshme ndaj një numri të madh të sëmundjeve të shkaktuara nga: kërpurdhat, bakteret, viruset, etj. sëmundje këto të cilat ndikojnë negativisht në cilësinë, sasinë dhe shëndetin e bimëve (Ndala et al., 2019; Johnson, 2005). Nga sëmundjet të cilat prekin domaten pa dyshim se vrugu i domates shfaqet për çdo vit në vendin tonë duke i shkaktuar dëme të konsiderueshme kësaj kulture. Vrugun e domates e shkakton kërpudha fitopatogjene *Phytophthora Infestans* e cila është sëmundje e rëndësisë së veçantë ku gjatë infektimit të kulturës ulë cilësinë dhe rendimentin me ç'rast humbjet e tërësishme sipas hulumtimeve të autorëve të ndryshëm mund të shkojnë deri në 100% (Ndala et al., 2019).

Hulumtimi i ndjeshmërisë së varieteteve të domates ndaj *Phytophthora infestans* në mjediset e mbrojtura është zhvilluar në rajonin e Pejës, në fshatin Qyshk , përkatësisht në dy serra në të njëjtin lokalitet me tre kultivarë të përfshirë të domates (Diagrama, Rose dhe Runner). Eksperimenti është realizuar duke u bazuar në metodën e blloqeve të randomizuara në tri përsëritje. Në secilën përsëritje janë kontrolluar nga 5-10 bimë të domates gjatë tërë periudhës së vegjetacionit ku në intervale një javore janë marrë mostrat për analizë.

Mostrat e marra në këtë mënyrë në mjedise të mbrojtura janë mbjellur në baza ushqyese (Nutrition Agar dhe Potato Dextrose Agar) në mënyrë që të identifikohen patogjenët prezent. Për identifikimin e llojeve të paraqitura të patogjenëve në kulturën e domates janë përdorur çelësa dhe atlase të ndryshme fitopatologjike, ndërsa përpunimi statistikor i rezultateve është bërë përmes programit MSTAT-C.

Rezultatet, respektivisht informatat të cilat janë arritur gjatë hulumtimit të ndjeshmërisë së varieteteve të domates ndaj sëmundjes *Phytophthora Infestans* kanë rëndësi shkencore sepse për herë të parë kemi të dhëna mbi ndjeshmërinë që kanë këto varietete ndaj patogjenit në mënyrë praktike, ku edhe fermerët do të njoftohen për rrezikshmërinë e infektimit si dhe mënyrat më të mira të mbrojtjes nga ky patogjen.

ABSTRACT

Tomato (*Solanum lycopersicum*) is one of the most popular vegetable crops around the world. Tomato cultivation is increasing every day as a fresh crop for consumption and a main ingredient in many foods. Tomatoes grown in protected environments are susceptible to a large number of diseases caused by: fungi, bacteria, viruses, etc. these diseases that negatively affect the quality, quantity and health of plants (Ndala et al., 2019; Johnson, 2005). Of the diseases that affect tomatoes, there is no doubt that tomato blight appears every year in our country, causing significant damage to this crop. Tomato blight is caused by the phytopathogenic fungus *Phytophthora Infestans*, which is a disease of particular importance where during the infection of the culture reduces the quality and yield, in which case total losses according to the researches of different authors can go up to 100% (Ndala et al., 2019). The research on the sensitivity of tomato varieties to *Phytophthora infestans* in protected environments was developed in the region of Peja, in the village of Qyshk, namely in two greenhouses in the same locality with three tomato cultivars included (Diagrama, Rose and Runner). The experiment was carried out based on the method of randomized blocks in three repetitions. In each repetition, 5-10 tomato plants were checked during the entire vegetation period, where samples were taken for analysis at one-week intervals.

The samples obtained in this way in protected environments are planted on nutrient bases (Nutrition Agar and Potato Dextrose Agar) in order to identify the pathogens present. Different keys and phytopathological atlases were used to identify the types of pathogens present in the tomato crop, while the statistical processing of the results was done through the MSTAT-C program.

The results, respectively the information obtained during the research on the sensitivity of tomato varieties to the disease *Phytophthora Infestans* are of scientific importance because for the first time we have data on the sensitivity of these varieties to the pathogen in a practical way, where farmers will also be informed about the danger of infection as well as the best ways of protection from this pathogen.